



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.134/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Afiete Sada-Gllogjani dhe Nenad Lazić anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pasafatshme ankesa e identifikuar me numër A.nr.134/2019 datë 29.09.2019, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2019, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 27 Shtator 2019 në orën 15:30, në Komunën e Podujevës, kanë vërejtur se aktivistët e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), kanë shpërndarë materiale zgjedhore propagandues në hapësira publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 33 pika b) të LZP-së, dhe po ashtu shkelje e Rregullores Nr.13/2013, Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur një CD.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmëris së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5 paragrafi 5 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Rregullën Nr. 02/2015, ku përcaktohet: *“Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it, brenda 24 orëve nga shkelja e supozuar”*. Në këtë rast ankesa është paraqitur në PZAP me datë 29.09.2019 në ora 18:00, ndërsa shkelja e pretenduar supozohet se ka ndodhur me datë

27.09.2019 ne ora 15:30, nga kjo del se ankuesi ka paraqitur ankesë pas afati të përcaktuar me dispozitën e lartcekur ligjore.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 118 të LZP-së, lidhur me nenin 6 paragrafi 4 i Rregullave te Procedurave te PZAP-it, Nr. 02/2015.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr. 134/2019 me datë 02.10.2019

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevcy



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.